



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

*Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede /
Agriculture Development Agency*

THIRRJA PËR APLIKIM
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Me qëllim të mbështetjes së aftësisë konkurruese të sektorit agro-rural, rritjen e prodhimit dhe të produktivitetit, përmirësimin e sigurisë së ushqimit, përdorimin e teknologjisë moderne, diversifikimin e aktiviteteve në ferma dhe biznese rurale, mbrojtja e mjedisit dhe të resurseve natyrore, krijimin e vendeve të punës dhe zvogëlimin e bilancit negativ tregtar.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, shpallë thirrje për aplikim për fermerët, agro-përpunuesit dhe bizneset rurale për këto masa të Programit të Zhvillimit Rural 2020/21.

MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore:

- a. Sektori 101 - Pemë drufrutore
- b. Sektori 101.1.1 - Pemë arnore
- c. Sektori 101.2 - Serra

MASA 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore;

- a. Sektori 103.1- Përpunimi i qumështit
- b. Sektori 103.2- Përpunimi i mishit
- c. Sektori 103.3- Përpunimi i pemëve dhe perimeve
- d. Sektori 103.4- Prodhimi i verës

MASA 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve

- a. Nën-masa 302.1 – Bletaria prodhimi promovimi i mjaltit
- b. Nën-masa 302.3 – Përpunimi i prodhimeve në fermë
- c. Nën-masa 302.4 – Zhvillimi i aktiviteteve artizanale
- d. Nën-masa 302.7 – Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish.

MASA: Ujitja e tokave bujqësore.

Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtyre masave është 16,700,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë euro).

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në ueb-faqen www.azhb-ks.net dhe www.mbpzhr-ks.net, për të aplikuar online kliko këtu: <https://azhb-aplikimet.rks-gov.net>. Po ashtu mund të informoheni edhe në Zyret Rajonale të AZHB-së.

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 20.07.2020 - 20.08.2020 ora 16:00

Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në ueb-faqen e AZHB-së www.azhb-ks.net në të cilën gjendet linku: „Aplikimet online për PZHR “ për të aplikuar online kliko këtu: <https://azhb-aplikimet.rks-gov.net>, që dërgon në modulën e aplikimit online.

Në web - modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen dokumentet e nevojshme për aplikim.

Thirrja për aplikim për masa tjera të programit të Zhvillimit Rural 2020/21 do të bëhet gjatë muajve të ardhshëm për të cilën do të njoftoheni me kohë.

Kontaktet dhe vendet informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR/ AZHB				
Adresa: (Rruga „Ukshin Hoti“ kati i IX) 10,000 Prishtinë				
Nga e hëna deri të premten nga ora 10:00 - 12:00 dhe nga ora 13:00 - 15:00 tel 038/211-967 ose 038/212-647				
Zyret Rajonale të AZHB-së - Çdo ditë pune nga ora 08:00 - 16:00				
Nr	Regjioni	Adresat	Telefoni	E-maili
1	Prishtinë	Zona Industriale Fushë Kosovë, përballë „Maxi-Marketit“,	038/601 - 169	
2	Mitrovicë	„Mbretëresha Teutë“ pa nr.	028/522 - 501	
3	Pejë	Instituti Bujqësor „Fidanishtja“	039/431 - 276	
4	Gjakovë	„Marin Barleti“ nr. 2, kati III.	0390/320 - 992	
5	Prizren	„Avni Rrustemi“ 159	029/244 - 793	
6	Ferizaj	„Dëshmorët e Kombit“ pa nr.	0290/324 - 661	
7	Gjilan	Rr: „Bulevardi i Pavarësisë“ (Rr. e Ferizajt Soliteri, kati I)	0280/326 - 106	